



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 159 / 2025

Datë: 26 / 03 / 2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 6) të Ligjit Nr. 06L - 010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-149 dhe Ligjin Nr. 08/L-272, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Haki (Azem) Haziri, i emëruar Noter për territorin e Komunës së Gjilanit, fillon ushtrimin e detyrës së noterit me datë 07/04/2025.
2. Obligohet Noteri të filloj ushtrimin e detyrës së noterit në ditën e caktuar në pikën 1 të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Noterit Z. Haki Haziri;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Gjykatës Themelore në Gjilan;
- Odës së Noterëve të Kosovës;
- Departamentit për Politika Sistemit Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.



Albin Kurti

Ministre në detyrë e Drejtësisë